



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.46, datë 20/07/2005

**“PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË INVENTARIT PËR KALIM
NË PRONËSI TË BASHKISË SË TIRANËS TË DISA OBJEKTEVE
PUBLIKE DHE SIPËRFAQEVE TË GJELBËRTA”**

Në mbështetje të ligjit Nr.8652, dt.31/07/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, ligjit Nr.8743, dt.22/02/2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, neni 3, pika 3, ligjit Nr.8744, dt.22/02/2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, neni 3, gërma “ç”, “g”, dhe “i”, në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.500, dt.14/08/2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin në njësitë e qeverisjes vendore”, Udhëzimit Nr.3, dt.18/07/2002 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme të shtetit nga njësitë e qeverisjes vendore”, Udhëzimit Nr.15, dt.30/06/2003 “Për mënyrën e paraqitjes nga Njësitë e Qeverisjes Vendore të kërkesave për transferim në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike”, pika 1/a dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I;

1. Lista paraprake e Inventarit për kalim në pronësi të Bashkisë së Tiranës të disa shesheve publike dhe sipërfaqeve të gjelbërta me destinacion përdorimin – Sipërfaqe e gjelbër e Parkim nëntokësor dhe Sheshe publike e Parkim nëntokësor, është si më poshtë vijon:
Lulishte “Vëllezërit Frashëri”
Lulishte “Përballë Rognerit”
Parku “Rinia”
Sheshi “Avni Rustemi”
Sheshi përpara stadiumit “Qemal Stafa”
Sheshi përpara Stacionit të Trenit
2. Këto prona të kërkohen të transferohen nga Këshilli i Ministrave pranë Bashkisë së Tiranës, në pronësi dhe pa kufizim.
3. Për ndjekjen e procedurave ligjore në lidhje me zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Sektori i Inventarizimit të Pasurive të Paluajtshme pranë Drejtorisë së Administrimit të Aseteve.
4. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI